



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 29 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenit 64.2 pika (a) dhe (b) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 02.07.2013, nxjerr:

RREGULLËN ZGJEDHORE NR. 10/2013 RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE PËR KRYETARË TË KOMUNAVE

Neni 1

Dispozitat e Përgjithshme

Kjo rregull ka për qëllim të rregullojë: vëzhguesit e zgjedhjeve, emërimin e këshillave të vendvotimit, Listën Votuese, Votimin dhe numërimin brenda vendvotimeve, votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta, si dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimin financiar të partive politike për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Neni 2

Përkufizimet

- 2.1 **Me Raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave** - nënkuptohen zgjedhjet që zhvillohen ndërmjet dy kandidatëve të cilët në zgjedhjet për kryetarë të komunave kanë fituar numrin më të madh të votave, në komunën ku asnjë kandidat nuk ka fituar së paku 50% plus një (1) votë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme të hedhura në atë komunë në pajtim me nenin 9.6 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
- 2.2 **Me Periudhë të fushatës për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave** - nënkuptohet periudha kohore e përcaktuar me vendim të KQZ-së, për t'i lejuar subjektet politike që të zhvillojnë fushatën e tyre të zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Neni 3
Procedurat e zbatueshme

Të gjitha dispozitat në Rregullat përkatëse të zgjedhjeve të KQZ-së janë të zbatueshme gjatë zhvillimit të raundit të dytë të zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, përveç nëse ato janë zëvendësuar ose ndryshuar në mënyrë specifike nga kjo Rregull.

Neni 4
Vëzhguesit e zgjedhjeve

- 4.1 Vëzhguesit, e akredituar para ditës së zgjedhjeve të Raundit të parë, mund të vëzhgojnë raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.
- 4.2 Përfaqësuesit e subjekteve politike të certifikuar, OJQ-ve, organizatave qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatave ndërkombëtare që janë të specializuara dhe të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendeve të huaja apo mediave, mund të aplikojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për t'u akredituar për vëzhgimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, ose nëse tashmë janë të akredituar si organizatë e vëzhguesve, mund të dorëzojnë kërkesën për akreditim të vëzhguesve shtesë, jo më vonë se pesë (5) ditë para Ditës së Zgjedhjeve.

Neni 5
Emërimi i Këshillave të Vendvotimeve

- 5.1 Në secilin vendvotim do të shërbejë një (1) ekip i Këshillit të Vendvotimit (KVV), i cili do të reflektojë përbërjen e KQZ-së siç përcaktohet në nenin 74.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave neni 74.2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk është i zbatueshëm.
- 5.2 Sekretariati i KQZ-së do të kërkojë nga subjektet politike të konfirmojnë Listën e emëruar të anëtarëve të KVV-së nga Raundi i parë dhe t'i propozojnë ndryshimet eventuale, dhe t'ia paraqes KQZ-së për miratim jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë para ditës së zgjedhjeve.
- 5.3 Të dy kandidatëve të cilët garojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave duhet t'iu lejohet t'i kenë përfaqësuesit e tyre në KVV, sipas vendimit të KQZ-së. Subjektet politike të kandidatëve duhet t'i nominojnë përfaqësuesit e tyre. Nëse nuk ka nominime të mjaftueshme të pranuar nga ai subjekt politik, atëherë përbërja e KVV-së mbetet ashtu siç përcaktohet në nenin 5.1 të kësaj rregulle.

- 5.4 KQZ- do t'i emërojë 10% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KVV-ve, të përcaktuar në nenin 79.1 të LZP, si anëtarë rezervë të KVV-së. Anëtarët rezervë të KVV-ve duhet të zgjedhën nga mesi i anëtarëve të KVV-ve që kanë shërbyer në ekipet e numërimit dhe/ose në ekipet e votimit apo si anëtarë rezervë për zgjedhjet komunale.
- 5.5 KQZ-ja do t'i emërojë ekipet e KVV-së, jo më vonë se shtatë (7) ditë para ditës së zgjedhjeve, në bazë të rekomandimeve që merren nga ZLKZ-të.

Neni 6

Lista e votuesve

Lista e njëjtë e votuesve që është shfrytëzuar për zgjedhjet komunale, do të përdoret për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Neni 7

Votimi dhe numërimi brenda vendvotimeve

- 7.1 Në ato komuna ku do të zhvillohet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave, numri i qendrave të votimit dhe lokacionet e tyre duhet të jenë të njëjta, ashtu siç kanë qenë në zgjedhjet komunale.
- 7.2 Anëtarët e KVV-së do të ndërmarrin dy veprimet, si ekip i votimit dhe si ekip i numërimit.
- 7.3 Me qëllim të përputhjes së rezultateve të vendvotimit, gjatë raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave do të përdoret formulari i përputhjes së të dhënave dhe i rezultateve (FPR), një kopje e të cilit i është bashkëngjitur kësaj Rregulle si Shtojca 1.
- 7.4 Votuesi do të votojë duke e shënjuar njërin prej kandidatëve në fletëvotim, në mungesë të fletëvotimeve të printuar me emrat e kandidatëve që garojnë për Raundin e dytë, votuesit do të votojnë duke shënjuar në fletëvotim, ose numrin e kandidatit, emrin dhe mbiemrin e kandidatit, dhe/ose emrin e subjektit politik të kandidatit.
- 7.5 Fletëvotimi do të konsiderohet i pavlefshëm ashtu siç përcaktohet në nenin 21.10 të Rregullës së Zgjedhjeve të KQZ-së nr. 09/2013 "Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe

Menaxhimi i Qendrës së Votimit ". Përveç tjerash, nëse emri dhe mbiemri i kandidatit, numri i kandidatit ose emri i subjektit politik të shkruar në fletëvotim nuk janë të kandidatit të njëjte, fletëvotimi është i pavlefshëm,

Neni 8

Votimi jashtë Kosovës

Te gjithë votuesit të cilët janë regjistruar me sukses si votues për votimin jashtë Kosovës mund të votojnë për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, nëse i përkasin komunës në të cilën do të mbahet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Neni 9

Votimi i personave me nevoja dhe rrethana të veçanta

Vetëm votuesit me zotësi juridike të cilët janë regjistruar me sukses si votues VPNRRV për Zgjedhjet Komunale në pajtim me nenin 3.1 të Rregullës së Zgjedhjeve nr. 04/2013 Votimi i personave me nevoja të veçanta, mund të votojnë në ato komuna ku do të mbahet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetarë të komunave.

Neni 10

Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar

Përveç kërkesave të përcaktuara në Rregullën e Zgjedhjeve nr.12/2013 Kufizimi i shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar, të gjitha subjektet politike, kandidatët e të cilave janë kualifikuar për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, duhet t'i dorëzojnë Zyrës formularin e kompletuar të Deklarimit Financiar të fushatës, për periudhën që fillon nga dita e parë pas ditës së zgjedhjeve të raundit të parë dhe që përfundon me ditën e zgjedhjeve të raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë kalendarike pas këtyre zgjedhjeve.

Neni 11

Dispozitat kalimtare përfundimtare

11.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore numër 10/2009 Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave, e datës 29.06.2009.

- 11.2 Pjesë përbërëse e kësaj rregulle është edhe:
Shtojca - I Formulari i Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR)

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn ne fuqi me datë 02.07.2013.

Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

